



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2021:156692

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05524834

NE ËMËR TE POPULLIT

P.nr.537/21

GJYKATA THEMELORE PEJË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija në çështjen penale kundër të pandehurit L. D. për shkak të veprës penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP.nr.1134/21 të datës 28.07.2021, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datat 18.03.2024, të cilën seancë prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit L. D. me mbrojtësen e tij Av.Valbona Berbati, me datë 18.03.2024 shpalli, ndërsa me datë 28.03.2024 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri :

L. D., i lindur me date ..... në fsh. R., Komuna Pejë, i biri i A. dhe nenës S., e gjinisë B., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion automekanik, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar ne baze te letërnjoftimit me nr..... lëshuar nga MPB R-Kosovës, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

LIROHET NGA AKUZA

Gjëja se :

Më parë e në vazhdimësi gjer me datë 28.06.2020, në kohë të panjohur, në Bjeshkët e S., K. Pejë, pjesë e parkut kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” (zonë e veçantë e mbrojtur), në cilësinë e pronarit,

investon në ndërtimin e objektit të banimit, pa leje të ndërtimit kur me ligj kërkohet një leje e tillë<sup>1</sup>, në mënyrën që, i pandehuri L. duke e ditur se nuk ka një leje nga organi kompetent (MMPH) për kryerjen e punimeve ndërtimore në vendin e lartcekur, investon në ndërtimin e një objekti të banimit nga materiali fortë-vrazhdë për çka me datën 28.06.2020 në vendin e ngjarjes dalin zyrtarët e DAPK-së dhe evidentojnë punimin ndërtimor pa leje në procesverbal me nr ....

-me çka kishte për të kryer veprën penale “Ndërtimi pa leje” nga neni 359, par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës mbeten në barren e mjeteve buxhetore të gjykatës.

### ARSYETIM

#### a) Historiku i çështjes;

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, me datën 28.07.2021 ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/II Nr. 1134/21 kundër të pandehurit L. D. për shkak të veprës penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Gjykatat e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 18.03.2024 në të cilën seancë prezentuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, i pandehuri L. D. me mbrojtësen e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare Av.Valbona Berbati.

Me qëllim të vërtetimit të veprës penale përkatësisht fakteve të përshkruara në aktakuzë, gjykata e beri administrimin e provave materiale të propozuara nga palët, ku pas vleresimit të këtyrë provave gjykata e nxori përfundimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsye të do të paraqitën në vijim të këtij aktgjykimi.

#### b) Faktet e çështjes (pretendimet e akuzës) ;

Prokurori i Shtetit në aktakuzën që është objekt shqyrtimi në këtë procedurë penale, pretendon se të i pandehuri L. D., më parë e në vazhdimësi gjer me datë 28.06.2020, në kohë të panjohur, në Bjeshkët e S., K. Pejë, pjesë e parkut kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” (zonë e veçantë e mbrojtur), në cilësinë e pronarit, investon në ndërtimin e objektit të banimit, pa leje të ndërtimit

---

<sup>1</sup> Ligji Nr. 04/L-110.

kur me ligj kërkohet një leje e tillë<sup>2</sup>, në mënyrën që, i pandehuri L. duke e ditur se nuk ka një leje nga organi kompetent (MMPH) për kryerjen e punimeve ndërtimore në vendin e lartcekur, investon në ndërtimin e një objekti të banimit nga materiali fortë-vrazhdë për çka me datën 28.06.2020 në vendin e ngjarjes dalin zyrtarët e DAPK-së dhe evidentojnë punimin ndërtimor pa leje në procesverbal me nr 00383.

Nga këto përshkrime shihet se prokuroria ka renditur faktet mbi bazën e te cilave e akuzon të pandehurin se ka ndërtuar pa leje si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke paraqitur si veprime te kryerjes faktin se i pandehuri në Bjeshkët e S., K. Pejë, pjesë e parkut kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” (zonë e veçantë e mbrojtur), në cilësinë e pronarit, investon në ndërtimin e objektit të banimit, pa leje të ndërtimit kur me ligj kërkohet një leje e tillë.

c) Baza ligjore (Vepra penale me të cilën ngarkohet i pandehuri);

Me qllim që të sqarohet qëndrimi i gjykatës në lidhje me fajsinë e të pandehurit, fillimisht do të bejmë një trajtim të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri përkatësisht do të paraqesim elementet konstituive të kësaj vepre penale, mënyrën dhe format e kryerjes së sajë.

I pandehurit L. D. ka kryer veprën penale Ndërtim pa leje nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së:

Në dispozitën e nenit 359 par. 2, të KPRK-së thuhet së: *“Personi i cili është pronar, investitor apo personi përgjegjës i subjektit juridik, i cili është investitor në objektin në ndërtim pa leje ndërtimi, kur me ligj kërkohet një leje e tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim...”*

*Ndërsa në paragrafin 4 të këtij neni thuhet së: Nëse vepra nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet në pronë publike apo shtetërore, në pronën e tjetrit, në zonat e mbrojtura, zonat e veçanta, zonat e veçanta të mbrojtura, zonat me interes të veçantë ekonomik, zonat sanitare për përdorimin e ujit ose zonat e mbrojtur për qëllime strategjike, kryesi dënohet me burgim prej...”*

Pra këtë vepre penale mund ta kryej personi i cili është pronar, investitor dhe personi përgjegjës i personit juridik i cili është pronar i objektit në ndërtim pa leje. Kjo vepër penale është e

---

<sup>2</sup> Ligji Nr. 04/L-110.

karakterit blanket sepse udhëzon në aplikimin e ligjit për ndërtim. Pra veprimi i kryerjes së kësaj vepre është në shkeljet e ligjit për ndërtim e ne rastin konkret neneve 7 dhe 14 të këtij ligji.

**d) Provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, vlerësimi dhe çmuarja e tyre;**

Gjatë shqyrtimit gjyqësor para kësaj gjykata u administruan provat materiale, si në vijim:  
Procesverbali mbi kontrollin e kryer nga DAPK- Bjeshkët e Nemuna me nr..... i dt.28.06.202, Informim i dt.28.06.2020 i përpiluar nga tekniku I.L., Procesverbali i marrjes në pyetje i të pandehurit L. D. pranë Prokurorisë Themelore në Pejë, dhe Foto dokumentacioni.

I pandehuri L. D. në mbrojtjen e tij të dhënë në gjykatë deklaroi së “ Objektivin e kam ndërtuar në bjeshkën e S.në vitin 2016 dhe e kam përfunduar në fund të vitit 2020, të cilin e kam ndërtuar mbi themelet e atij që ka qenë përpara dhe gjatë kësaj kohe nuk kam qenë në dijeni së është i ndaluar ndërtimi deri atëherë kur kanë ardhur inspektorët në muajin qershor të vitit 2020, aty na kanë njoftuar se është i ndaluar ndërtimi dhe kanë bërë një procesverbal, nëse do të kisha ditur se është ndaluar dhe kërkohet leja, do të kisha kërkuar lejen”.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit i njëjti sqaron se “unë jam investitor i ndërtimit të këtij objekti të cilin është pronë shoqërore, punimet e këtij objekti i kam vazhduar edhe gjatë vitit 2019 deri në qershor të vitit 2020, po në këtë bjeshkë të S. ka pasur të ndërtuar edhe nga bashkëfshataret e mijë, nuk kam biseduar me bashkëfshataret e mijë rreth kushteve ligjore të cilat kërkohet leje për ndërtimin e tyre”.

Në pyetjen e gjykatës i njëjti deklaron se “nga koha kur është bërë inspektimi nuk kam bere ndonjë punim ndërtimor vetëm i kam vendosur dyert dhe dritaret të cilin objekt e kam ndërtuar vete që do të thotë se kam punuar vazhdimisht prej vitit 2016 pak nga pak”.

Gjykata e vlerësoj mbrojtjen e të pandehuri L. D. dhe erdhi në përfundim se të njëjtit duhet falur besimi, pasi që mbrojtja e tij është në përputhje edhe me provat e tjera që janë administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri e ka përshkruar në detaje se si ka filluar ndërtimi ne këtij objekt, si e ka punuar nga pak gjatë viteve dhe se pas ndalimit nga inspektorët nuk ka ndërmarr asnjë veprim ndërtimor.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare mbeti në tersi pran akuzës dhe kualifikimit juridik të saj, duke shprehur bindjen se pas administrimit të provave materiale dhe personale u vërtetua përtej dyshimit mirë të bazuar se i pandehuri L. D. objektin-stanin të cilin e ka ndërtuar, ndërtimin e tij e kishte filluar në vitin 2016, mirëpo e kishte vazhduar me ndërtim edhe gjatë vitit 2020, andaj prokurori propozoi që të pandehurit ti shpallët fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit si dhe ti obligoj në pagurjen e shpenzimeve të procedurës penale.

Mbrojtësja e të pandehurit L. D., av. Valbona Berbati në fjalën përfundimtare deklaroj se pas deklaratës së të mbrojturit tim L. D., gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, u pa qartë se kemi të bëjmë me padijeninë e të mbrojturit tim lidhur me atë se derisa ky e ka ndërtuar atë objekt është shpallur me Ligj si park kombëtar. Prokurori i çështjes u thirr në atë se do ta dij çdo kush, se është fakt notor, mirëpo jo çdo kosh e din se KPPRK- ka hyrë në fuqi në vitin 2019, jo çdo kush është jurist me ditë ligjin me dëgju çka thotë Kodi Penal, me qenë se i mbrojturi im është punëtor në auto servis, dhe punon tërë ditën për ta mbajtur familjen vetë, dhe nuk ka kohë të dëgjoj se kur hyri në fuqi Kodi Penal, apo kur u shpall në vend park nacional, apo çka do tjetër, në raste kur një vepër sanksionohet me Kodin Penal, atëherë duhet të njoftohen personat laik në këtë drejtim dhe në mënyra më të përshtatshme dhe duke vendosur me shenja se këtu është park nacional dhe është e i ndaluar ndërtimi. Në këtë rast i mbrojturi im askund nuk ka pa shenjë se ndalohe ndërtimi, andaj i propozon gjykatës që të mbrojturin tim ta shpall të pafajshëm dhe siç cekim edhe vetë ndërtimin e ka ndal kur kanë ardhur inspektorët dhe në atë momente objekti ka qenë i kryer.

I pandehuri L. D. në fjalën përfundimtare deklaroj se pajtohet me mbrojtësen e tij dhe nuk ka çka të shtojë tjetër.

e) Vlerësimi përfundimtar i gjykatës në lidhje me çështjen (Vëndimi në lidhje me fajsinë);

Gjykata duke u bazuar në nenin 7 dhe nenin 8 par.2 të KPPRK-së i vlerësoj provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe nxori përfundimin se vepra për të cilën akuzohet i pandehuri nuk përbën vepër penale, e si rrjedhojë i njëjti u lirua nga akuza për arsyet si ne vijim.

Në këtë çështje penale nuk është kontestuese se i pandehuri L. D. ka ndërtuar objekt në bjeshkën e S., pjesë e parkut kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, e gjithashtu nuk është kontestuese se i pandehuri për këtë ndërtim nuk ka pasur leje nga organet kompetente.

Gjithashtu është vërtetuar se punimet ndërtimore të objektit të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi kanë filluar në vitin 2016 dhe kanë përfunduar në vitin 2020, fakti cili u vërtetua me deklaratën e të pandehurit.

Mirëpo, gjykata duke e vlerësuar gjendjen faktike, provat e administruara dhe mbrojtjen e të pandehurit të dhënë në shqyrtim gjyqësor erdhi në përfundim se në këtë rast vepra me të cilën akuzohet i pandehuri nuk përbën vepër penale, pasi që kjo vepër nuk ka qene e përcaktuar me ligj si vepër penale në kohën kur i pandehuri e ka filluar ndërtimin.

Këtë përfundim gjykata e nxori duke u bazuar në faktin se i pandehuri e ka filluar punimet e objektit në vitin 2016 në kohën kur veprimi i ndërtimit pa leje nuk ka qene i inkriminuar si vepër penale, pasi që është fakt notor se kodi penale që e inkriminon këtë vepër ka hyrë në fuqi në muajin Prill të vitit 2019.

Gjykata konsideron se veprimi i kryerjes së të pandehurit është ndërmarr në vitin 2016, në kohën kur e ka filluar ndërtimin e objektit, kohë në të cilën ndërtimi pa leje nuk ka qene i inkriminuar, e dihet se për tu inkriminuar një veprim kërkohet që të jetë ndërmarr në kohën kur është përcaktuar me ligj si vepër penale.

Faktin se cila konsiderohet koha kryerjes së veprës penale e ka rregulluar nenin 9 i KPRK-së ku thuhet “Vepra penale kryhet në kohën kur kryesi ka vepruar apo ka qene i detyruar të veprojë pa marrë parasysh kohën kur është shkaktuar pasoja”.

Në këtë kontekst gjykata e vlerësoj faktin se punimi i këtij objekti ka zgjatur nga viti 2016 deri në vitin 2020, periudhë në të cilën ndërkohë është inkriminuar kjo vepër, mirëpo gjykata veprimin e ndërtimit nuk e konsideron as vepër penale në vazhdim e as vepër penale permanente, pasi që të rasti i parë kërkohet që i pandehuri me disa veprime të ketë kryer disa vepra penale, ndërsa të rasti i dytë kërkohet që me një veprim të jete kryer një vepër mirëpo që pasoja e sajë e përcaktuar me ligj të jete në kontinentet, pra kundërligjshmëria të jete aktive në një kohëzgjatje të caktuar, e cila pasojë duhet të ketë unitet edhe objektiv edhe subjektiv.

E në rastin e ndërtimit pa leje kundërligjshmëria shfaqet në momentin e fillimit të ndërtimit, ku në aspektin objektiv konsiderohet si një veprim i kryerjes nga nisja deri në përfundimin e

ndërtimit ose deri në momentin kur ndërtimi ndalohet nga organet kompetentet, ndërsa në aspektin subjektiv kundërligjshmëria shfaqet në momentin kur dashja për të ndërtuar pa leje shprehet ne boten e jashtme ne momentin e fillimit të ndërtimit.

Andaj, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, pas administrimit të provave dhe vlerësimit të njësive, e në bazë të elaborimeve të lartcekura, gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me veprë penale, ashtu siç është bërë përshkrimi faktik në diapozitivin e këtij aktgjykimi, pasi që veprimi i kryerjes nuk ka qene i inkriminuar ne kohen kur është ndërmarrë nga i pandehuri.

Vendimi në lidhje me shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 453 par. 1, të KPPRK-së, ku thuhet “Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykimi me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449, paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore, përveç në rastet e caktuara në paragrafët vijues të këtij neni”.

Andaj, duke u mbështetur në të thënat si me lartë dhe në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 dhe neni 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.537/21, me datë 28.03.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale  
Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:  
Leon Përlaska

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.